

VENDIM
Nr.233, datë 21.2.2008

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MJEDISEVE TË
RADIOSTACIONIT TË KASHARIT NGA RADIOTELEVIZIONI PUBLIK SHQIPTAR TE
MINISTRIA E FINANCIVE DHE PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
RADIOTELEVIZIONIT PUBLIK SHQIPTAR TË MJEDISEVE TË ATELIESË SË RE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11,13, shkronja “c”, e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e radiostacionit të Kasharit, në pronësi të Radiotelevizionit Publik Shqiptar, t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave, për t'u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të përballuar shpenzimet e transferimit, të përdorë fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2008.
 3. Objekti “Atelie e re”, me sipërfaqe të përgjithshme 3804 m², në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, t'i kalojë në përgjegjësi administrimi Radiotelevizionit Publik Shqiptar.
 4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Radiotelevizioni Publik Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

Zyra Vendore e Regjistrimit
të Pasurive të Paluajtshme
TIRANË

REGJISTRUESI

MAJLINDA BOZGO

Vula

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 211P NR PASURISË _____ VEH _____

INDEKSI I HARTES K-3488(230-B) SHALLI A _____

ADRESA E PASURISË Rrethi TIRANË KATUN _____

Rr/L _____ PG _____ SH _____ K _____

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

V. _____

L. _____

J. _____

P. _____

D. Data: _____ Orë: _____



